

Në bazë të nenit 18 dhe 104 të Ligjit për shoqëri dhe fondacione (Gazeta zyrtare e RM – së nr 52/10 dhe 135/11, nenit 156 nga Ligji për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM – së nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13 dhe 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145,14 dhe 154/15) dhe nenit 339 dhe 334 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2016 solli këtë:

STATUT

të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës

(Tekst i konsoliduar)

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Statut të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës (në tekstin e mëtejshëm: Parlamenti Studentor i Universitetit) rregullohen: statusi ligjor, mënyra për ta ushtruar rolin, detyrat dhe aktivitetet, organet e njësitë dhe përbërja e tyre, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve në organet dhe njësitë dhe mënyra e vendosjes, përfaqësimi dhe prezantimi, mënyra e fitimit dhe disponimit me mjetet financiare, transparenca dhe llogaridhënia në punë, pjesëmarrja e studentëve në udhëheqjen e Universitetit, zgjedhja e Avokatit të studentëve dhe çështje të tjera me rëndësi për realizimin e aktiviteteve të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 2

Për realizimin e interesave të përbashkëta të studentëve si bashkëpunëtorë në procesin e arsimit të lartë, studentët formojnë Shoqatë të qytetarëve – Parlamentin Studentor të Universitetit, me shoqërim të lirë të studentëve, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare, fetare, gjinore për realizimin dhe kryerjen e aktiviteteve me qëllim të përfaqësimit të interesave të përbashkëta para Universitetit, Parlamentit studentor ndëruniversitar, organeve të Republikës së Maqedonisë, publikut dhe opinionit publik.

Shoqata e qytetarëve – Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës është formuar me vendim për transformimin e Unionit të studentëve të Universitetit të Tetovës në shoqatën e qytetarëve – Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës, i sjellë më 04.12.2009.

Neni 3

Studentët marrin pjesë në udhëheqjen e Universitetit të Tetovës nëpërmjet përfaqësuesve të studentëve, të cilët i zgjedhin në Parlamentin Studentor të Universitetit, Parlamentin studentor ndëruniversitar dhe Parlamentet studentore të fakulteteve.

Neni 4

Pjesëmarrja e studentëve në organet e Universitetit, në Parlamentin Studentor të Universitetit, çështjet për të cilat vendosin në mënyrë të barabartë, numrin, mënyrën e zgjedhjes dhe çështjet e tjera me rëndësi për realizimin e të drejtave të tyre, rregullohen me Statutin e Universitetit, Rregulloret e fakulteteve të Universitetit dhe me këtë Statut.

Pjesëmarrja e studentëve në konferenca ndëruniversitare rregullohet me Statutin e konferencave ndëruniversitare.

Neni 5

Anëtar i Parlamentit Studentor të Universitetit mund të jetë secili student i Universitetit, i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Parlamenti Studentor i Universitetit si shoqatë, qëllimet e veta, detyrat dhe aktivitetet i realizon në pajtim me ligjin, Statutin e Universitetit, këtë Statut, si dhe me aktet tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë çështjet e kësaj natyre.

Neni 7

Parlamentin Studentor të Universitetit e përfaqëson dhe e prezanton kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Emri dhe selia

Neni 8

Emri i plotë i shoqatës është: Shoqata – Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës – Tetovë (në tekstin e mëtejme: Parlamenti Studentor i Universitetit).

Shkurtesa e emrit të Parlamentit Studentor të Universitetit është: PS – USHT.

Neni 9

Selia e Parlamentit Studentor të Universitetit është në Tetovë, në Bulevardin e Ilindenit pa numër.

Subjektiviteti juridik

Neni 10

Parlamenti Studentor i Universitetit është subjekt juridik.

Parlamenti Studentor i Universitetit fiton statutin e subjektit juridik me regjistrimin në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë.

Veprimtaria publike

Neni 11

Puna e Parlamentit Studentor të Universitetit është publike.

Mbledhjet e organeve të Parlamentit Studentor të Universitetit janë publike dhe e transparente për mjetet e informimit publik.

Parlamenti Studentor i Universitetit për punën, vendimet e organeve dhe veprimtarinë e tij e informon opinionin përmes shtypit ditor, radios dhe televizionit.

Parlamenti Studentor i Universitetit ka faqen e vet zyrtare në internet, përmes së cilës realizohet qasja e të dhënave relevante dhe informacioneve nga veprimtaria dhe puna e parlamentit.

Parlamenti Studentor i Universitetit mund të botojë Buletine në pajtim me ligjin, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Puna publike e Parlamentit Studentor të Universitetit realizohet përmes shpalljes publike të Statutit dhe akteve tjera në pajtueshmëri me këtë Statut.

Dhënia e llogarisë dhe përgjegjësia

Neni 12

Dhënia e llogarisë dhe përgjegjësia e Parlamentit Studentor të Universitetit realizohen përmes:

- Dorëzimit të raportit vjetor të punës së organeve të Parlamentit Studentor të Universitetit në kuadër të Universitetit dhe opinionit më të gjërë;
- Dorëzimit të raportit për punën financiare para organeve kompetente të përcaktuara me ligj, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut;
- Për vërtetimin e zbatimit të Statutit dhe programit si dhe për ndjekjen e punës së Parlamentit Studentor të Universitetit, mund të formojë organ për mbikqyrje;
- Kompetencat e organit për mbikqyrje përcaktohen me aktin e formimit të tij në pajtim me ligjin, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Vula, simboli dhe shënimet tjera

Neni 13

Parlamenti Studentor i Universitetit ka vulë dhe shtembil (vulë katrore).

Vula ka formë rrethore me diametër 3cm dhe përmban fjalët: Shoqata-Parlamenti i Studentëve të Universitetit të Tetovës - Tetovë, Здружение -Студентски парламент на Државниот Универзитет во Тетово - Тетово, ndërsa në mes figuron emblema e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Shtembili i Parlamentit Studentor të Universitetit është kënddrejtë me dimensione 5cm me 3 cm dhe i përmban fjalët e shkruara në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

**Shoqata-Parlamenti i Studentëve
të Universitetit të Tetovës**

**Numër _____
_____ 20 _____**

**Здружение-Студентскиот Парламент на
Државниот универзитетот во Тетово**

**Број _____
_____ 20 _____ година**

Emblemën e Parlamentit Studentor të Universitetit e përcakton vetë ai.

Qëllimet dhe detyrat e Parlamentit Studentor të Universitetit

Neni 14

Parlamenti Studentor i Universitetit siguron unitet në kryerjen e qëllimeve dhe detyrave të Parlamentit Studentor të Universitetit dhe Parlamentit studentor të fakulteteve drejtpërdrejt dhe përmes njësive të veta - Parlamentit studentor të fakulteteve. Ai siguron unitet edhe në realizimin e të drejtave të studentëve, që kanë të bëjnë me sistemin e arsimit të lartë si tërësi.

Qëllimet dhe detyrat e Parlamentit Studentor të Universitetit janë:

1. Përfaqësimi i studentëve para organeve dhe trupave të Universitetit dhe fakulteteve;
2. Mbrojtja dhe realizimi i të drejtave të studentëve;
3. Realizimi i të drejtave të studentëve lidhur me çështjet dhe problemet, që kanë të bëjnë me sistemin e arsimit të lartë si tërësi;
4. Pjesëmarrja në udhëheqjen e Universitetit, si dhe gjatë marrjes së vendimeve dhe çështjeve të tjera të rëndësishme e me vlerë për funksionimin e Universitetit dhe fakulteteve;
5. Realizimi dhe plotësimi i nevojave kulturore të studentëve, i aktiviteteve rekreative sportive, krijimtarisë shkencore-teknike, shëndetësore, humanitare dhe aktiviteteve të tjera të dobishme;
6. Realizimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me organizatat studentore në Republikën e Maqedonisë dhe në shtetet tjera jashtë vendit;
7. Trajtimi, vlerësimi dhe vendimmarrja lidhur me çështjet aktuale, të cilat janë me interes dhe rëndësi për studentët.

ORGANET DHE TRUPAT E PARLAMENTIT STUDENTOR TË UNIVERSITETIT DHE FAKULTETEVE

Organet dhe trupat e Parlamentit Studentor të Universitetit

Neni 15

Organet e Parlamentit Studentor të Universitetit janë: Parlamenti Studentor i Universitetit, Kryetari dhe Kryesia.

Parlamenti Studentor i Universitetit

Pozita dhe përbërja

Neni 16

Parlamentin Studentor të Universitetit e përbëjnë përfaqësuesit e Parlamenteve studentore të fakulteteve.

Anëtarët e Parlamentit Studentor të Universitetit zgjidhen në përputhje me kriteret dhe parimet e përcaktuara me Rregulloren për zgjedhje, emërim dhe propozim të studentëve në organet dhe njësitë e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Parlamentit janë:

- T'i përfaqësojë dhe prezantojë studentët e fakulteteve përkatëse në organet dhe trupat e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe në organet e trupat e Universitetit në përgjithësi;
- Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet dhe trupat e Parlamentit Studentor të Universitetit;
- Të propozojë zgjidhje të çështjeve me interes të përbashkët;

-Të zotohet për zhvillimin dhe avancimin e aktiviteteve shoqërore dhe aktiviteteve tjera, të cilat rezultojnë nga ky Statut, nga qëllimet dhe detyrat programore dhe nga vendimet dhe konstatimet e miratuara;

-T'i implementojë në tërësi dispozitat ligjore nga ky Statut dhe nga aktivitetet programore;

-T'i përfaqësojë interesat dhe qëndrimet e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 17

Parlamentin Studentor të Universitetit e përbëjnë:

- 1) Katër (4) përfaqësues të zgjedhur nga Parlamentet Studentore të fakulteteve;
- 2) Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit, i cili sipas funksionit është anëtar i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 18

Parlamenti Studentor i Universitetit i organizon mbledhjet sipas nevojës.

Mbledhjet i thërret Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit. Iniciativën për organizimin e mbledhjeve të parlamentit mund ta parashtrojnë edhe 1/5 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Mënyra e organizimit të mbledhjeve të Parlamentit Studentor të Universitetit përcaktohet me Rregulloren për punë të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Rregullorja nga paragrafi i kaluar miratohet me 2/3 e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 19

Mandati i anëtarëve të Parlamentit Studentor të Universitetit zgjat 2 vjet.

Mandatin e anëtarëve të Parlamentit Studentor e verifikon Komisioni për verifikim i përbërë nga tre anëtarë, i zgjedhur nga radhët e Parlamentit studentor të Universitetit.

Anëtarët e Komisionit për verifikim zgjidhen me propozim të anëtarëve të Parlamentit studentor të sapozgjedhur.

Në punën dhe vendimet e Parlamentit nuk mund të marrin pjesë studentët, mandati i të cilëve nuk është verifikuar.

Anëtarit të Parlamentit i ndërpritet mandati:

- Nëse e revokon fakulteti i cili e ka pëzgjedhur sipas procedurës dhe mënyrës së njejtë për zgjedhjen e tij;
- Nëse i ndërpritet statusi i studentit;
- Me kërkesë të tij;
- Në raste tjera të përcaktuara me ligj, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Me vendim të Parlamentit studentor të Universitetit, anëtarit nga paragrafi i mëparshëm, i ndërpritet mandati. Vendimi miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit.

Neni 20

Parlamenti Studentor i Universitetit:

- E sjell Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit, e ndryshon dhe e plotëson atë;

-Me propozim të Kryetarit i zgjedh dhe i shkarkon anëtarët e kryesisë;

-Me propozim të Kryesisë i zgjedh dhe i shkarkon kryetarët e komisioneve të Parlamentit Studentor të Universitetit;

- Propozon kandidatë për Avokatin e studentëve, pas konkursit të shpallur nga Senati i Universitetit për zgjedhjen e Avokatit të studentëve;

-E zgjedh u.d. Kryetarin;

-Sjell Rregullore për zgjedhje, emërim dhe propozim të studentëve në organet dhe trupat e Universitetit;

-Në pajtim me Statutin e Universitetit, pas konkursit të realizuar, propozon kandidatë për senatorë dhe anëtarë të komisioneve nga radhët e studentëve;

-E sjell Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit, Kryetar të Parlamentit Studentor të njësisë dhe anëtarë të Parlamentit Studentor të fakultetit;

-E zgjedh komisionin zgjedhor për realizimin e procesit zgjedhor të studentëve;

-E sjell Rregulloren për punën e Parlamentit Studentor të Universitetit;

-E miraton planin për punën e Parlamentit Studentor të Universitetit për një periudhë kohore prej 2 vjetësh, të operacionalizuar në programe vjetore;

-E shqyrton dhe miraton raportin për punën e Kryesisë mes dy mbledhjeve të Parlamentit Studentor të Universitetit;

-E ndjek gjendjen materiale-financiare të Parlamentit Studentor të Universitetit;

-Sjell plan financiar dhe e miraton llogarinë përfundimtare të Parlamentit Studentor të Universitetit;

-Diskuton për rezultatet e arritura nga puna e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe jep udhëzime për punën e mëtejme të Parlamentit;

-Sjell vendime, përfundime, deklarata, rekomandime për zgjidhjen e çështjeve me interes për studentët;

-Shpall zgjedhje për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit, Kryetarit të Parlamentit Studentor të njësisë dhe anëtarët e Parlamentit Studentor të fakultetit

-Vendos për anëtarësimin e Parlamentit Studentor të Universitetit në organizatat regjionale dhe ndërkombëtare;

-Parlamenti Studentor i Universitetit, me propozim të Kryesisë së Parlamentit Studentor të Universitetit, mund ta shkarkojë Parlamentin studentor të fakultetit me 2/3 e shumicës së votave. Procedura përcaktohet me Rregullore të posaçme, të sjellë nga Parlamenti me 2/3 e shumicës së votave;

-Vendos për ndërprerjen e punës së Parlamentit Studentor të Universitetit;

-Sjell vendime për shpërblimin, lëvdimin dhe dekorimin e anëtarëve të dalluar, aktivistëve dhe përkrahësve të Parlamentit Studentor të Universitetit;

-E miraton emblemën e Parlamentit Studentor të Universitetit;

-Kryen edhe punë të tjera, të cilat rezultojnë nga Statuti i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Parlamenti studentor i Universitetit vendos në mënyrë absolute nëse janë të pranishëm më shumë se ½ nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Mënyra e punës

Neni 21

Punët me kompetencë të tij, Parlamenti Studentor i Universitetit i kryen në pajtueshmëri me ligjin, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Për rregullimin e punëve me kompetencë të tij, Parlamenti Studentor i Universitetit sjell vendime, rregullore, udhëzime dhe përfundime.

Punët me kompetencë të tij Parlamenti i kryen në mbledhje. Parlamenti mund të mbajë mbledhje solemne me rastin e jubileve, ceremonive e të ngjashme.

Neni 22

Mbledhjet e Parlamentit Studentor të Universitetit i thërret dhe me ta udhëheq Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Parlamenti Studentor i Universitetit konvokohet edhe me kërkesë të së paku 3 fakulteteve të Universitetit, me kërkesë të Udhëheqësisë së Parlamentit Studentor të Universitetit dhe me kërkesë të 1/5 së anëtarëve të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 23

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit në afat kohor prej 7 ditësh para mbajtjes së mbledhjes, të gjithë anëtarëve të Parlamentit u dorëzon ftesë me propozim për rendin e ditës dhe materiale për pikat e rendit të ditës.

Në raste urgjente mbledhja mund të thirret edhe para përfundimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Parlamenti mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme në pajtim me Rregulloren për punë të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 24

Vendimet dhe aktet tjera të miratuara në mbledhjet e Parlamentit Studentor të Universitetit i nënshkruan Kryetari.

Dispozita më të përafërta për mënyrën e punës së Parlamentit Studentor të Universitetit përcaktohen me Rregulloren për punë të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Komisionet

Neni 25

Parlamenti Studentor i Universitetit formon komisione për hulumtimin dhe përgatitjen e propozimeve për çështjet që janë nga sfera e punës së Parlamantit.

Parlamenti Studentor i Universitetit me vendim i përcakton kompetencën dhe përbërjen e komisioneve dhe i emëron kryetarët, gjatë së cilës duhet mbajtur llogari për përfaqësimin e anëtarëve të komisioneve nga fusha të ndryshme mësimore – shkencore gjegjësisht njërive të ndryshme të Universitetit.

Neni 26

Mbledhjet e komisioneve i cakton kryetari i komisionit përkatës me iniciativë personale, ndërsa është i detyruar të thërrasë mbledhje, nëse një gjë të tillë e kërkon Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit ose 1/5 e anëtarëve të komisionit, duke i njoftuar ata paraprakisht për pikat, që do të jenë në rend dite në atë mbledhje.

Kryetari i komisionit është përgjegjës për punën e komisionit.

Kryetari i komisionit, çdo 6 muaj, paraqet raport për punën e komisionit deri te Parlamenti Studentor i Universitetit.

Neni 27

Komisioni mund t'i zhvillojë punimet e veta, nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve të komisionit, kurse vendimet sillen me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm.

Neni 28

Për shkak të hulumtimit të çështjeve të caktuara, që kanë të bëjnë me kompetencën e tyre dhe për përgatitjen e raporteve apo draft vendimeve për nevojat e Parlamentit Studentor të Universitetit, komisionet mund të angazhojnë mësimdhënës, bashkëpunëtorë, studentë dhe punonjës tjerë të Universitetit.

Në punën e komisionit mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë, pa të drejtë vendosjeje.

Neni 29

Parlamenti Studentor i Universitetit formon komisione për:

- Arsim dhe shkencë;
- Standardin e studentëve;
- Bashkëpunim ndërkombëtar;
- Veprimtari normative;
- Sport;
- Marrëdhënie me publikun dhe marketingun;
- Financa;
- Ekologji dhe
- Komisione tjera sipas nevojës.

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit

Neni 30

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit e prezanton dhe e përfaqëson Parlamentin Studentor të Universitetit.

Kryetari i kryen dhe i realizon të drejtat dhe detyrimet në kuadër të ligjit, Statutit të Universitetit, këtij Statuti dhe akteve tjera të Universitetit dhe Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 31

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, me mandat 2 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Zgjedhjet nga paragrafi i mësipërm mbahen në semestrin dimëror.

Kryetar i Parlamentit Studentor të Universitetit zgjidhet kandidati, i cili ka marrë shumicë votash nga studentët e regjistruar në Universitet, të cilët kanë dalë në zgjedhje dhe kanë votuar.

Neni 32

Kryetar i Parlamentit Studentor të Universitetit mund të zgjidhet një student i rregullt i Universitetit të Tetovës, shtetas i Republikës së Maqedonisë, , me notë mesatare 7,00.

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe kryetar i Parlamentit Studentor të fakultetit apo të kryejë ndonjë funksion në parti politike.

Kandidati/kandidatët për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit duhet ta kenë përkrahjen e 1000 (njëmijë) nënshkrimeve të studentëve, prej të cilave detyrimisht nga 7 fakultete të ketë/kenë prej 50-100 nënshkrime.

Kandidatët për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit me dorëzimin e kandidaturave për kryetar, dorëzojnë kandidaturat për 11 kandidatë për Kryetarë në Parlamentet Studentore të fakulteteve dhe 20 kandidatura për anëtarë në Parlamentet Studentore të fakulteteve.

Mënyra e dorëzimit të kandidaturave nga paragrafi i mësipërm i këtij neni, do të rregullohet me Rregulloren për organizim të zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit Shtetëror të Tetovës dhe në njësitë të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Neni 33

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit:

-I thirr dhe kryeson me mbledhjet e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe mbledhjet e Kryesisë së Parlamentit Studentor të Universitetit me të drejtë vote;

-I organizon dhe i miraton aktivitetet e Parlamentit Studentor të Universitetit;

-I propozon anëtarët e Kryesisë së Parlamentit Studentor të Universitetit;

-I zbaton vendimet dhe konkluzionet e sjella nga ana e Parlamentit dhe Kryesisë së Parlamentit Studentor të Universitetit;

-Vendos për disponimin e mjeteve në kuadër të planit financiar, në shumën, të cilën do ta përcaktojë Parlamenti Studentor i Universitetit;

-Emëron u.d. Kryetar të Parlamentit Studentor të fakultetit, nëse një gjë e tillë shihet si e nevojshme, në pajtim me aktin e posaçëm, të sjellë nga ana e Parlamentit Studentor të Universitetit. Akti sillet me shumicë votash nga anëtarët e Parlamentit Studentor të Universitetit.

-Lidh marrëveshje, vetëm jo në raste kur nevojitet autorizim i posaçëm nga ana e Parlamentit Studentor;

-Kryen edhe punë të tjera me kompetencë të tij në pajtim me këtë Statut dhe aktet e tjera të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 34

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit është përgjegjës për mosrespektimin e Statutit dhe akteve tjera në kryerjen e të drejtave dhe detyrimeve të veta.

Procedurë për konstatimin e përgjegjësisë së Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit mund të ngrenë gjysma e anëtarëve të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Për përgjegjësinë e Kryetarit vendos Parlamenti Studentor i Universitetit me 2/3 e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Kryesia

Neni 35

Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit është organ ekzekutiv i Parlamentit, në të cilin çdo anëtar gëzon të drejta të barabarta dhe bart detyrime dhe përgjegjësi për punën dhe progresin e Parlamentit Studentor të Universitetit, në pajtim me këtë Statut.

Neni 36

Parlamenti Studentor i Universitetit e zgjedh Kryesinë nga radhët e anëtarëve të vet, me mandat 2 vjeçar, me propozim të Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Kryesinë nga paragrafi i mësipërm e përbëjnë:

-11 anëtarë nga Parlamenti studentor i Universitetit;

-2 studentë në postin e zëvendësve të Kryetarit;

-1 anëtar në postin e Sekretarit të përgjithshëm;

-2 studentë anëtarë në Senatin e Universitetit.

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit është anëtar i Kryesisë me të drejtë vote.

Me propozim të Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit, 2 studentë zgjidhen zëvendës të Kryetarit, kurse 1 student sekretar i Kryesisë nga radhët e anëtarësisë së Kryesisë.

Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit i përgatit mbledhjet e Parlamentit.

Mandati i anëtarëve të Kryesisë së Parlamentit Studentor të Universitetit zgjat 2 vjet.

Neni 37

Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit:

- I realizon detyrat statutare dhe programore të Parlamentit Studentor të Universitetit si dhe vendimet dhe konkluzionet e Parlamentit;
- E sjell dhe e realizon programin vjetor për punën e Parlamentit;
- Propozon ndryshime dhe plotësime të Statutit të Parlamentit Studentor të Universitetit;
- Shpall konkurs për zgjedhje të Avokatit të studentëve të Universitetit;
- I sjell Rregulloret e Parlamentit Studentor të Universitetit;
- Sjell vendime për furnizim apo prishje të kontratës së mjeteve elementare;
- Vendos për disponimin e mjeteve në kuadër të planit financiar;
- Vendos për udhëtime zyrtare jashtë shtetit;
- Propozon kryetarë të komisioneve të Parlamentit Studentor të Universitetit;
- I përcakton kriteret për organizimin e brendshëm dhe punën e këshillave dhe organeve tjera, si dhe e kanalizon dhe e realizon mbikëqyrjen e funksionimit të tyre;
- Jep raport financiar deri te Parlamenti Studentor i Universitetit;
- Kryen edhe punë të tjera, të cilat ia beson Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 38

Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit organizohet dhe mban mbledhje sipas nevojës.

Mbledhjet e Kryesisë nga paragrafi i mësipërm i organizon Kryetari.

Neni 39

Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit, për punën e vet, bart përgjegjësi përpara anëtarëve të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit mund të shkarkohet nga ana e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit mund të propozojë shkarkimin e anëtarit të Kryesisë. Të drejtën e shkarkimit të anëtarit të Kryesisë e kanë edhe së paku 20% e anëtarëve.

Anëtari i Kryesisë së Parlamentit Studentor të Universitetit mund të japë dorëheqje.

Vendimin lidhur me çështjet nga paragrafët 2,3 dhe 4 të këtij neni e sjell Parlamenti Studentor i Universitetit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Kryesia shkarkohet edhe në rastet kur shumica e anëtarëve nuk e pranojnë raportin financiar për vitin rrjedhës.

Pas shkarkimit të Kryesisë, Parlamenti e obligon Kryetarin, që në një afat prej 10 ditësh, të propozojë përbërje të re të Kryesisë, në të cilën nuk mund të marrë pjesë asnjëri nga anëtarët e shkarkuar.

Neni 40

Në rast të dorëheqjes, shkarkimit apo pengimit të përhershëm të anëtarit të Kryesisë, Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit cakton ushtrues detyre deri në zgjedhjen e anëtarit të ri nga ana e Parlamentit Studentor.

Parlamenti Studentor i fakultetit

Neni 41

Parlamenti studentor i fakultetit është trajtë themelore e organizimit të studentëve në njësinë e Universitetit, ku shprehja e interesave të studentëve dhe harmonizimi i interesave të tyre individuale e kolektive bëhet në bazë të principeve demokratike.

Neni 42

Parlamenti studentor i fakultetit është organ i studentëve të njësisë së Universitetit. Parlamentin studentor të fakultetit e përbëjnë përfaqësuesit e studentëve të njësisë së Universitetit.

Puna e Parlamentit studentor të fakultetit përcaktohet me këtë Statut.

Neni 43

Çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, menaxhimin dhe financimin e Parlamentit studentor të fakultetit, rregullohen me këtë Statut, Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e fakulteteve.

Neni 44

Mënyra e financimit të Parlamentit Studentor të fakultetit është e rregulluar me vendim, të sjellë nga ana e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 45

Parlamenti studentor i fakultetit, si rregull, mban mbledhje një herë në muaj, përveç gjatë muajve korrik dhe gusht.

Vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve i dorëzohen Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 46

Iniciativë për formimin e Parlamentit studentor të fakultetit ngre Parlamenti Studentor i Universitetit.

Vendimin për formimin e Parlamentit studentor të fakultetit e sjell Parlamenti Studentor i Universitetit me 2/3 e shumicës së votave.

Neni 47

Parlamenti studentor i fakultetit është kompetent të diskutojë për të gjitha çështjet e përcaktuara me Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 48

Parlamenti studentor i fakultetit numëron nga 5 anëtarë nga secili vit akademik.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit studentor të fakultetit është 20 anëtarë, plus Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit. Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit ka të drejtë vote.

Anëtarët e Parlamentit studentor të fakultetit zgjidhen me mandat prej 2 vjetësh, me të drejtë rrizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Zgjedhjet për anëtarë të Parlamentit studentor të fakultetit i shpall Komisioni Zgjedhor i Universitetit.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit studentor të fakultetit doemos të jetë numër tek.

Neni 49

Studentët e fakultetit kanë të drejtë dhe detyrim të votojnë.

Neni 50

Zgjedhjet shpallen tre muaj para mbarimit të mandatit të përbërjes paraprake të Parlamentit, kurse mandati i anëtarëve të rinj fillon ditën e nesërme pas mbarimit të mandatit të përbërjes paraprake.

Mandati i anëtarëve të zgjedhur zgjat 2 vjet, kurse anëtarëve të zgjedhur nga viti i fundit, të ciklit të parë të studimeve universitare, mandati u zgjat deri në diplomimin e tyre, por jo më shumë se 2 vjet.

Anëtarit të Parlamentit i mbaron mandati edhe më parë, nëse atij i ndërpritet statusi i studentit ose nëse jep dorëheqje dhe në raste të tjera të përcaktuara me këtë Statut.

Gjatë mandatit mund të bëhet zëvendësimi i anëtarit të Parlamentit, ashtu që mandati i anëtarit të ri zgjat deri në skadimin e mandatit të paraardhësit të tij.

Në rastet nga paragrafi 3 dhe 4 të këtij neni, ngrihet procedurë për zgjedhje.

Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit

Neni 51

Kryetari e prezanton dhe e përfaqëson Parlamentin studentor të fakultetit.

Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta, me votim të fshehtë, me mandat prej 2 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

Për kryetar të Parlamentit studentor të fakultetit mund të zgjidhet studenti i rregullt, i cili është shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Neni 52

Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit:

-I thirr dhe kryeson me mbledhjet e Parlamentit studentor të fakultetit dhe me mbledhjet e Kryesisë së Parlamentit studentor të fakultetit me të drejtë vote;

-I organizon dhe i miraton aktivitetet e Parlamentit studentor të fakultetit;

-I propozon anëtarët e Kryesisë së Parlamentit studentor të fakultetit;

-I zbaton vendimet dhe konkluzionet e sjella nga ana e Parlamentit dhe Kryesisë së Parlamentit studentor të fakultetit;

-Kryen edhe punë të tjera në kompetencë të vet në pajtim me Statutin dhe aktet e tjera të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 53

Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit është përgjegjës për mosrespektimim e Statutit të Parlamentit Studentor të Universitetit dhe akteve tjera të Parlamentit studentor të Universitetit në kuadër të të drejtave dhe detyrimeve të veta.

Procedurën për konstatimin e përgjegjësisë së Kryetarit të Parlamentit studentor të fakultetit mund ta iniciojnë 1/3 e anëtarëve të Parlamentit.

Për përgjegjësinë e Kryetarit vendos Parlamenti studentor i fakultetit me 2/3 e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve dhe Parlamenti Studentor i Universitetit me 2/3 e

shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Kryesia

Neni 54

Parlamenti Studentor i fakultetit e zgjedh Kryesinë nga radhët e anëtarëve të vet, me mandat 2 vjeçar, me propozim të Kryetarit të Parlamentit studentor të fakultetit.

Kryesia përbëhet nga Kryetari dhe 8 anëtarë.

Kryetari është anëtar i Kryesisë me të drejtë vote.

Nga radhët e anëtarëve të Kryesisë, me propozim të Kryetarit, zgjidhet zëvendësi i Kryetarit.

Kryetari i përgatit dhe i thirr mbledhjet e Parlamentit studentor të fakultetit.

Parlamenti studentor i fakultetit mund ta shkarkojë Kryesinë me 2/3 e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Neni 55

Kryesia e Parlamentit studentor të fakultetit:

-I realizon detyrat programore të Parlamentit studentor të fakultetit si dhe vendimet dhe konkluzionet e Parlamentit;

-E sjell dhe e realizon programin vjetor për punën e Parlamentit;

-Sjell vendime për shpërblime, lëvdata dhe mirënjohje;

-Sjell vendime për furnizim apo prishje të kontratës për furnizim të mjeteve elementare;

-Vendos për disponimin e mjeteve në kuadër të planit financiar;

-Vendos për udhëtime zyrtare jashtë shtetit;

-Propozon kryetarë të komisioneve të Parlamentit Studentor të Universitetit;

-I përcakton kriteret për organizimin e brendshëm dhe punën e këshillave dhe organeve tjera, si dhe e kanalizon dhe e realizon mbikëqyrjen e funksionimit të tyre;

-Jep raport financiar deri te Parlamenti Studentor i fakultetit;

-E miraton emblemën e Parlamentit Studentor të fakultetit;

-Kryen edhe punë të tjera, të cilat ia beson Parlamenti Studentor i fakultetit apo Parlamenti Studentor i Universitetit.

Neni 56

Kryesia e Parlamentit studentor të fakultetit organizohet dhe mban mbledhje sipas nevojës.

Mbledhjet e kryesisë i thërret Kryetari.

Neni 57

Kryesia e Parlamentit studentor të fakultetit për punën e vet bart përgjegjësi përpara anëtarëve të Parlamentit studentor të fakultetit.

Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit mund të propozojë shkarkimin e anëtarit të Kryesisë së Parlamentit studentor të fakultetit.

Anëtari i Kryesisë së Parlamentit studentor të fakultetit mund të japë dorëheqje.

Vendimin lidhur me çështjet nga paragrafët e mëparshëm e sjell Parlamenti studentor i fakultetit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Kryesia shkarkohet edhe në rastet kur shumica e anëtarëve nuk e pranojnë raportin financiar për vitin rrjedhës.

Pas shkarkimit të Kryesisë, Parlamenti e obligon Kryetarin, që në një afat prej 10 ditësh, të propozojë përbërje të re të Kryesisë, në të cilën nuk mund të marrë pjesë asnjëri nga anëtarët e shkarkuar.

Neni 58

Në rast të dorëheqjes, shkarkimit apo pengimit të përhershëm të anëtarit të Kryesisë, Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit cakton ushtrues detyre deri në zgjedhjen e anëtarit të ri nga ana e Parlamentit.

Komisionet

Neni 59

Parlamenti studentor i fakultetit formon komisione për hulumtimin dhe përgatitjen e propozimeve, që kanë të bëjnë me çështjet e spektrit të punës së Parlamentit.

Neni 60

Mbledhjet e komisioneve i cakton kryetari i komisionit përkatës me iniciativë të vet, ndërsa është i detyruar të thërrasë mbledhje, nëse një gjë të tillë e kërkon Kryetari i Parlamentit studentor të fakultetit ose 1/5 e anëtarëve të komisionit, duke i njoftuar ata paraprakisht për pikat, që do të jenë në rend dite në atë mbledhje.

Kryetari i komisionit është përgjegjës për punën e komisionit.

Kryetari i komisionit çdo 6 muaj paraqet raport për punën e komisionit deri te Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 61

Komisioni mund t'i zhvillojë punimet e veta, nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve të komisionit, kurse vendimet sillen me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm.

Neni 62

Për shkak të hulumtimit të çështjeve të caktuara, që kanë të bëjnë me kompetencën e tyre dhe për përgatitjen e raporteve apo propozim vendimeve për nevojat e Parlamentit studentor të fakultetit, komisionet mund të angazhojnë mësimdhënës, bashkëpunëtorë, studentë dhe punonjës tjerë të Universitetit.

Neni 63

Secili parlament studentor i fakultetit vendos në mënyrë të pavarur për llojin dhe numrin e komisioneve të punës.

Avokati i studentëve

Neni 64

Për mbrojtjen e të drejtave të studentëve të Universitetit zgjidhet Avokati i studentëve.

Avokati i studentëve i mbron të drejtat ligjore të studentëve, të përcaktuara me aktet e Universitetit dhe me aktet e njërive, kur ato u cenohen nga ana e organeve të Universitetit dhe organeve të njësisë akademike, si dhe nga personat e kyçur në procesin edukativo - arsimor dhe nga persona të tjerë, të përcaktuara me aktin e Avokatit të studentëve, të cilin e sjell Senati i Universitetit.

Neni 65

Avokati i studentëve zgjidhet nga radhët e studentëve të Fakultetit të shkencave të drejtësisë, që ka kryer të paktën semestrin e katërt dhe me mesatare të notave 8.00.

Avokati i studentëve zgjidhet nga ana e Senatit të Universitetit, me propozim të Parlamentit Studentor të Universitetit, për një mandat prej 2 vjetësh, pa të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Nëse Parlamenti Studentor i Universitetit apo Këshilli i rektoratit konstaton mosbesim në punën e Avokatit të studentëve, Senati i Universitetit nis procedurë për shkarkimin e tij.

Neni 66

Avokati i studentëve jep betim publik përpara Senatit të Universitetit, se funksionin e tij do ta kryejë me përgjegjësi, duke u mbështetur në ligj dhe në aktet ligjore të Universitetit.

Avokati i studentëve së paku, një herë në vit, paraqet raport për punën e tij deri të Këshilli i rektoratit, Senati i Universitetit dhe Parlamenti Studentor i Universitetit.

Neni 67

Avokati i studentëve disponon me buxhetin e vet në kuadër të buxhetit të Universitetit.

Neni 68

Përgjegjësia, zgjedhja dhe puna e Avokatit të studentëve miratohet me akt të Senatit të Universitetit dhe Statutin e Universitetit.

Shërbimi administrativ-teknik i Parlamentit Studentor

Neni 69

Për kryerjen e punëve administrative-teknike, punëve ndihmëse dhe punëve të ngjashme me interes të përgjithshëm, si dhe për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Parlamentit Studentor të Universitetit dhe Parlamenteve studentore të fakulteteve formohet shërbimi administrativ-teknik i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Neni 70

Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e shërbimit administrativ-teknik përcaktohen me akt të veçantë, të cilin e sjell Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit, në pajtim me ligjin, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Neni 71

Mjetet për punën e Shërbimit administrativ-teknik caktohen me planin financiar të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Pjesëmarrja e studentëve në udhëheqjen e Universitetit

Neni 72

Studentët marrin pjesë në udhëheqjen e Universitetit përmes përfaqësuesve të tyre, të cilët i zgjedhin në Parlamentin Studentor të Universitetit, në Parlamentin studentor ndëruniversitar, në organet e njësisë, përmes formave të vetorganizimit apo në ndonjë mënyrë tjetër, në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe me Statutin e Universitetit.

Parlamenti Studentor i Universitetit dhe Parlamenti studentor ndëruniversitar u mundësojnë studentëve realizimin e interesave të përbashkëta si partnerë në procesin e arsimit sipëror.

Pjesëmarrja e studentëve në organet e Universitetit, në organet e njësisë, në Parlamentin Studentor, çështjet për të cilat ata vendosin në mënyrë të barabartë, numrin, mënyrën e zgjedhjes dhe çështjet e tjera me rëndësi për realizimin e të drejtave të tyre, rregullohen me Statutin e Universitetit dhe me Rregulloren e njësisë përkatëse të Universitetit.

Pjesëmarrja e studentëve në Parlamentin ndëruniversitar, çështjet për të cilat ata vendosin në mënyrë të barabartë, numrin, mënyrën e zgjedhjes dhe çështjet e tjera me rëndësi për realizimin e të drejtave të tyre, më së afërmi rregullohen me Statutin e Parlamentit ndëruniversitar.

Financimi i Parlamentit Studentor të Universitetit

Neni 73

Parlamenti studentor i Universitetit ka llogarinë e vet, në të cilën udhëhiqen mjetet e fituara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, Universiteti i Tetovës, mjetet nga dhënia e shërbimeve në organe, organizata, bashkësi dhe persona tjerë juridik dhe mjete të fituara nga burime tjera në pajtueshmëri me ligjin dhe Statutin e Universitetit.

Në tregtinë ligjore me persona të tretë, Parlamenti studentor i Universitetit paraqitet me emrin e vet dhe për logarinë e tij. Për obligimet e marra në tregtinë ligjore me persona të tretë, Parlamenti Studentor i Universitetit jep llogari me mjetet e fituara në një mënyrë që është në pajtueshmëri me paragrafin paraprak të këtij neni.

Disponimi me mjetet e fituara nga legu, dhuratat, testamentet dhe shtojcat tjera realizohet sipas qëllimit të dhënësit në pajtim me këtë Statut.

Neni 74

Me të ardhurat e fituara nga paragrafi 1 i nenit 73, Parlamenti Studentor i Universitetit disponon sipas kriterëve dhe qëllimit të përcaktuar nga dhënësit e mjeteve të vërtetuar në këtë nen, gjegjësisht në mënyrën e përcaktuar me ligj, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Neni 75

Për shfrytëzimin dhe disponimin e mjeteve vendosin organet e Parlamentit Studentor të Universitetit, në pajtueshmëri me kompetencat e përcaktuara me këtë Statut.

Neni 76

Parlamenti Studentor i Universitetit sjell plan financiar vjetor për fitimet dhe shpenzimet e Parlamentit.

Plani financiar i përmban të ardhurat, të cilat realizohen sipas nenin 73 të këtij Statuti, si dhe shpenzimet për aktivitetet shoqërore, për pagat e të punësuarve, harxhimet e përbashkëta të të punësuarve, harxhimet materiale për punë dhe shpenzimet tjera, që ndërlidhen me punën e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe të fakulteteve.

Parlamenti Studentor i Universitetit, së paku një herë në vit, paraqet përpara anëtarëve të vet raport financiar.

Ndërprerja e aktiviteteve të Parlamentit Studentor

Neni 77

Parlamenti Studentor i Universitetit mund ta ndërpresë punën e tij në kushte të përcaktuara me ligj, Statutin e Universitetit dhe këtë Statut.

Neni 78

Pas ndërprerjes së aktivitetit të Parlamentit Studentor të Universitetit, prona dhe të drejtat e tjera dhe të ardhurat, të cilat mbesin pas shlyerjes së obligimeve, kalojnë në pronësi të Universitetit.

Procedura për sjelljen e akteve të përgjithshme të Parlamentit Studentor të Universitetit

Neni 79

Draft aktet e përgjithshme të Parlamentit Studentor të Universitetit përgatiten nga organet e punës së Parlamentit Studentor të Universitetit.

Pas vërtetimit të draft aktit të përgjithshëm nga Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit, ai i dorëzohet për miratim Parlamentit Studentor të Universitetit.

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe akteve të përgjithshme kryhen në mënyrën dhe procedurën sipas të cilave sillen.

Aktet e përgjithshme shpallen në Buletinin e Parlamentit Studentor të Universitetit.

Aktet e përgjithshme hyjnë në fuqi në ditën e shpalljes së tyre.

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 80

Ky Statut hyn në fuqi 8 (tetë) ditë nga dita e sjelljes së tij.

Neni 81

Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti përfundojnë të vlejnjë dispozitat e Statutit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës të miratuar më 04.12.2009.

Neni 82

Organet dhetrupat e Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, që janë zgjedhur deri në hyrjen në fuqi të këtij Statuti vazhdojnë të kryejnë funksionin për mandatin në të cilin janë zgjedhur.

Neni 83

Në afat prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës do t'i sjellë aktet e fushëveprimit të tij.

Neni 84

Pëlqim për ndryshime dhe plotësime të këtij Statuti jep Parlamenti Studentor i Universitetit.

KRYETARI

I Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës